**L I G J**
**Nr.9026, datë 13.3.2003**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË "KONVENTËN PËR NJOFTIMIN E SHPEJTË TË NJË AKSIDENTI BËRTHAMOR"**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në "Konventën për njoftimin e shpejtë të një aksidenti bërthamor".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3752, datë 26.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**
**Alfred Moisiu**

**KONVENTË**
PËR NJOFTIMIN E SHPEJTË TË NJË AKSIDENTI BËRTHAMOR

Shtetet Pjesëmarrëse të kësaj Konvente:

të ndërgjegjshëm se veprimtaritë bërthamore po zhvillohen në një numër shtetesh;

duke vërejtur se janë marrë masa dhe po merren masa të gjithanshme për të siguruar një nivel të lartë sigurie në veprimtaritë bërthamore, me qëllim që të parandalohen aksidentet bërthamore dhe të minimizohen pasojat e ndonjë aksidenti të tillë, në qoftë se ai ndodh;

duke dëshiruar të forcojnë më tej bashkëpunimin ndërkombëtar për një zhvillim dhe përdorim të sigurt të energjisë bërthamore;

të bindur për nevojën që kanë shtetet për të administruar një informacion të bazuar në lidhje me aksidentet bërthamore sa më shpejt që të jetë e mundur, me qëllim që pasojat radiologjike ndërkufitare të mund të minimizohen;

duke vërejtur dobinë e marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe për shkëmbim informacioni në këtë fushë,

ranë dakord për sa më poshtë:

Neni 1
**Fusha e zbatimit**

1. Kjo Konventë do të zbatohet në rastin e çdo aksidenti që përfshin objekte ose veprimtari të një Shteti Pjesëmarrës ose të personave ose subjekteve juridike nën juridiksionin ose kontrollin e tij, sipas paragrafit 2 të mëposhtëm, që çon ose pritet të çojë në çlirim lëndësh radioaktive dhe që rezulton ose mund të rezultojë në kalimin e këtyre lëndëve përtej kufijve shtetëror, ngjarje e cila mund të jetë e rëndësishme për sigurinë radiologjike të një shteti tjetër.

2. Objektet dhe veprimtaritë, të cilave u referohet paragrafi 1 janë:

a) çdo reaktor bërthamor kudo që të jetë vendosur;

b) çdo impiant me cikël karburanti bërthamor;

c) çdo impiant që trajton mbetje radioaktive;

d) transporti dhe magazinimi i karburantit bërthamor ose i mbetjeve radioaktive;

e) prodhimi, përdorimi, ruajtja, groposja dhe transporti i radioizotopeve për qëllime mjekësore, bujqësore, industriale, dhe në lidhje me kërkimin dhe shkencën në këto fusha;

f) përdorimi i radioizotopeve për përftim (gjenerim) energjie në objektet në hapësirën kozmike.

Neni 2

**Njoftimi dhe informimi**

Në rast të ndonjë aksidenti të përcaktuar në nenin 1 (që këtej e tutje do të quhet "aksident bërthamor"), Shteti Pjesëmarrës, të cilit i referohet ai nen duhet:

a) Të njoftojë menjëherë, direkt ose nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (që këtej e tutje do të quhet "Agjencia") ato shtete, që janë ose mund të jenë fizikisht të ndikuara sikurse përcaktohet në nenin 1 dhe Agjencinë, për aksidentin bërthamor, natyrën e tij, kohën e ndodhjes dhe vendndodhjen e saktë, kur është e nevojshme.

b) T'u japë menjëherë informacionin e duhur shteteve që u referohet nënparagrafi (a), direkt ose nëpërmjet Agjencisë, në mënyrë që të pakësohen pasojat radiologjike në këto shtete, sikurse specifikohet në nenin 5.

Neni 3

**Aksidente të tjera bërthamore**

Me qëllim që të pakësohen pasojat radiologjike,Shtetet Pjesëmarrëse mund të njoftojnë edhe për raste aksidentesh bërthamore të ndryshme nga ato që tregohen në nenin 1.

Neni 4

**Funksionet e Agjencisë**

Agjencia:

a) Do të njoftojë menjëherë Shtetet Pjesëmarrëse, Shtetet Anëtare, shtetet e tjera që janë ose mund të jenë fizikisht të ndikuara sikurse specifikohet në nenin 1 dhe organizatat ndërqeveritare ndërkombëtare relevante (që këtej e tutje do të quhen "organizata ndërkombëtare") për çdo njoftim të marrë në përputhje me nënparagrafin (a) të nenit 2.

b) Do t'ua japë menjëherë, me kërkesën e tyre, informacionin e marrë sipas nënparagrafit (b) të nenit 2 çdo Shteti Pjesëmarrës, Shteti Anëtar ose organizate ndërkombëtare relevante .

Neni 5

**Informacioni që duhet të jepet**

1. Informacioni që do të jepet sipas nënparagrafit (b) të nenit 2 do të përmbajë të dhënat e mëposhtme, sikurse ato disponohen nga Shteti Pjesëmarrës që bën njoftimin:

a) Koha, vendndodhja e saktë, kur është e nevojshme dhe natyra e aksidentit bërthamor.

b) Objekti ose veprimtaria e përfshirë.

c) Shkaku i supozuar ose i njohur dhe parashikimi për zhvillimin e mëtejshëm të aksidentit bërthamor lidhur me daljen jashtë kufijve të lëndëve radioaktive.

d) Karakteristikat e përgjithshme të daljes radioaktive, duke përfshirë sa është e mundur praktikisht dhe e nevojshme, natyrën, formën e mundshme fizike dhe kimike, sasinë, përbërjen dhe lartësinë efektive të daljes radioaktive.

e) Informacion për kushtet meteorologjike dhe hidrologjike të çastit dhe të parashikuara për të ardhmen, të nevojshme për të parashikuar daljen jashtë kufijve të lëndëve radioaktive.

f) Rezultatet e kontrollit të mjedisit lidhur me daljen jashtë kufijve të lëndëve radioaktive.

g) Masat mbrojtëse jashtë vendit të aksidentit, të marra ose të planifikuara.

h) Dinamika në kohë e parashikuar për daljen radioaktive.

2. Ky informacion do të plotësohet në intervale të përshtatshme me informacione të tjera relevante për zhvillimin e situatës së jashtëzakonshme, duke përfshirë përfundimin aktual ose të parashikuar të saj.

3. Informacioni i marrë sipas nënparagrafit (b) të nenit 2, mund të përdoret pa kufizime, përveç rasteve kur ky informacion është siguruar nëpërmjet njoftimit konfidencial nga ana e Shtetit Pjesëmarrës.

Neni 6
**Këshillimet**

Një Shtet Pjesëmarrës që jep informacion sipas nënparagrafit (b) të nenit 2 në atë masë që është e arsyeshme, do t'i përgjigjet menjëherë kërkesës për informacion të mëtejshëm ose për këshillime, që vjen prej një Shteti Pjesëmarrës të ndikuar nga aksidenti, në mënyrë që të pakësohen pasojat radiologjike në atë shtet.

Neni 7
**Autoritetet kompetente dhe pikat e kontaktit**

1. Çdo Shtet Pjesëmarrës do t'u bëjë të ditur Agjencisë dhe Shteteve të tjera Pjesëmarrëse, direkt ose nëpërmjet Agjencisë, autoritetet e veta kompetente dhe pikën e kontaktit, që është përgjegjëse për dhënien dhe marrjen e njoftimit dhe informacionit sipas nenit 2. Këto pika kontakti dhe një pikë qendrore brenda Agjencisë do të jenë të disponueshme në mënyrë të vazhdueshme.

2. Çdo Shtet Pjesëmarrës do të njoftojë menjëherë Agjencinë për çdo ndryshim që mund të ndodhë në informacionin sipas paragrafit 1.

3. Agjencia do të mbajë një listë të azhurnuar të këtyre autoriteteve kombëtare, si dhe pikave të kontaktit të organizatave ndërkombëtare relevante dhe do ta shpërndajë këtë listë tek të gjitha Shtetet Pjesëmarrëse, Shtetet Anëtare dhe organizatat ndërkombëtare relevante.

Neni 8
**Ndihma për Shtetet Pjesëmarrëse**

Agjencia në përputhje me statutin e saj dhe me kërkesën e një Shteti Pjesëmarrës që nuk ka veprimtari të veta bërthamore dhe as kufij me një shtet jopjesëmarrës që zhvillon një program aktiv bërthamor, do të bëjë studime për nevojën dhe vendosjen e një sistemi të përshtatshëm monitorimi të rrezatimeve, në mënyrë që të lehtësojë arritjen e objektivave të kësaj Konvente.

Neni 9
**Marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe**

Në përputhje me interesat e tyre reciproke, Shtetet Pjesëmarrëse kur e shohin të përshtatshme, mund të marrin në konsideratë përfundimin e marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe lidhur me çështjet që trajton kjo Konventë.

Neni 10
**Lidhja me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare**

Kjo Konventë nuk do të ndikojë mbi të drejtat dhe detyrimet reciproke të Shteteve Pjesëmarrëse, që rrjedhin nga marrëveshjet ekzistuese ndërkombëtare, të cilat lidhen me çështje që mbulon kjo Konventë ose që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të së ardhmes të përfunduara në përputhje me objektin me qëllimin e kësaj Konvente.

Neni 11
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Në rast mosmarrëveshje ndërmjet Shteteve Pjesëmarrëse ose ndërmjet një Shteti Pjesëmarrës dhe Agjencisë, lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, palët që nuk merren vesh do të konsultohen, me qëllim që të zgjidhin mosmarrëveshjet me anë bisedimesh ose me ndonjë mjet tjetër paqësor të pranueshëm prej tyre.

2. Nëse një mosmarrëveshje e këtij karakteri ndërmjet Shteteve Pjesëmarrëse nuk mund të zgjidhet brenda një viti pas kërkesës për konsultim sipas paragrafit 1, me kërkesën e çdo pale në mosmarrëveshje, çështja i kalon arbitrazhit ose Gjykatës Ndërkombëtare për vendim. Nëse brenda gjashtë muajve nga data e kërkesës për të çuar mosmarrëveshjen në arbitrazh, palët janë të paafta të bien dakord për organizimin e arbitrazhit, çdo palë mund t'i kërkojë Presidentit të Gjykatës Ndërkombëtare ose Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të caktojë një ose më shumë arbitra. Në rast kërkesash kondradiktore nga palët në mosmarrëveshje, kërkesat drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara do të kenë përparësi.

3. Gjatë nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, një shtet mund të deklarojë se nuk e konsideron veten të lidhur nga njëra ose të dyja procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të treguara në paragrafin 2, ndaj një Shteti Pjesëmarrës për të cilin mbetet në fuqi një deklaratë e tillë.

4. Një Shtet Pjesëmarrës, që ka bërë një deklaratë në përputhje me paragrafin 3, mund ta tërheqë atë në çdo kohë duke njoftuar Depozituesin.

Neni 12

**Hyrja në fuqi**

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për firmosje për të gjitha shtetet dhe nga Namibia, e përfaqësuar nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për Namibinë, në rezidencën e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike në Vjenë dhe në rezidencen e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork prej 26 shtatorit 1986 dhe 6 tetorit 1986 përkatësisht, deri në hyrjen e saj në fuqi ose për dymbëdhjetë muaj, duke zgjedhur periudhën më të gjatë.

2. Një shtet dhe Namibia, e përfaqësuar nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për Namibinë, mund të shprehin miratimin se bashkohen me këtë Konventë ose duke e firmosur, ose duke depozituar një instrument ratifikimi, pranimi ose miratimi të shoqëruar me firmosjen që bëhet subjekt ratifikimi, pranimi ose miratimi, ose duke depozituar një instrument aderimi. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit do të depozitohen tek Depozituesi.

3. Kjo Konventë hyn në fuqi tridhjetë ditë pasi të jetë shprehur pranimi i saj nga tre shtete.

4. Për çdo shtet që shpreh pëlqimin për t'u lidhur me këtë Konventë pas hyrjes në fuqi, kjo Konventë do të hyjë në fuqi për shtetin tridhjetë ditë pas datës së shprehjes së pëlqimit.

5. a) Kjo Konventë do të jetë e hapur për aderim, sikurse sigurohet nga ky nen, nga organizatat ndërkombëtare dhe organizatat rajonale integruese që formohen nga shtete sovrane, të cilat kanë kompetencat për të bërë negociata, përfundime dhe zbatime të marrëveshjeve ndërkombëtare për fusha që i mbulon kjo Konventë.

b) Brenda kompetencave të tyre këto organizata, në emër të tyre do të ushtrojnë të drejtat dhe do të plotësojnë detyrimet që kjo Konventë u atribuon Shteteve Pjesëmarrëse.

c) Kur depoziton instrumentin e vet të aderimit, një organizatë e tillë do t'i komunikojë Depozituesit një deklaratë, ku i tregon shtrirjen e kompetencave të saj në lidhje me fushat që mbulon kjo Konventë .

d) Një organizatë e tillë nuk përbën ndonjë votë shtesë për votat e Shteteve Pjesëmarrëse.

---

Shënim : Sipas nenit 12.3, Konventa hyri në fuqi me 27 tetor 1986.

Neni 13

**Zbatimi i përkohshëm**

Një shtet që nga momenti i firmosjes ose në çdo kohë tjetër përpara kohës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për këtë shtet, mund të deklarojë se do të zbatojë këtë Konventë përkohësisht.

Neni 14
**Amendamenti**

1. Një Shtet Pjesëmarrës mund të propozojë amendamente për këtë konventë. Amendamenti i propozuar do t'i dërgohet Depozituesit, i cili do ta qarkullojë atë menjëherë në të gjitha Shtetet Pjesëmarrëse.

2. Nëse shumica e Shteteve Pjesëmarrës i kërkon Depozituesit të thërrasë një konferencë për të shqyrtuar amendanentin e propozuar, Depozituesi do të ftojë të gjitha Shtetet Pjesëmarrëse të vijnë në këtë konferencë që fillon jo më parë se tridhjetë ditë pas dërgimit të ftesave. Çdo amendament, që pranohet nga konferenca me dy të tretat e votave të të gjitha Shteteve Pjesëmarrëse, do të futen në një protokoll që është i hapur për firmosje në Vjenë dhe në Nju Jork nga të gjitha Shtetet Pjesëmarrëse.

3. Protokolli hyn në fuqi tridhjetë ditë pas pëlqimit të shprehur nga tre shtete. Për çdo shtet që shpreh pëlqimin për të qenë i lidhur me këtë protokoll, pasi ai ka hyrë në fuqi, protokolli do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pas ditës së shprehjes së pëlqimit.

Neni 15
**Denoncimi**

1. Një Shtet Pjesëmarrës mund ta denoncojë këtë Konventë duke njoftuar me shkrim Depozituesin.

2. Denoncimi merr fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Depozituesi.

Neni 16
**Depozituesi**

1. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë do të jetë Depozituesi i kësaj Konvente.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë do të njoftojë menjëherë të gjitha Shtetet Pjesëmarrëse dhe shtetet e tjera për:

a) çdo firmosje të kësaj Konvente ose ndonjë protokoll amendamenti;

b) çdo depozitim të një instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi lidhur me këtë Konventë ose me ndonjë protokoll amendamenti;

c) çdo deklaratë ose tërheqje deklarate në përputhje me nenin 11;

d) çdo deklaratë për zbatim të përkohshëm të kësaj Konvente sipas nenit 13;

e) hyrjen në fuqi të kësaj Konvente ose të ndonjë amendamenti të saj;

f) çdo denoncim të bërë sipas nenit 15.

Neni 17
**Tekstet origjinale dhe kopjet e vërtetuara**

Origjinali i kësaj Konvente, tekstet e së cilës në gjuhë arabe, kineze frënge, ruse dhe spanjolle janë njëlloj autentike, do të depozitohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike, i cili do t'u dërgojë kopje të vërtetuara Shteteve Pjesëmarrëse dhe të gjitha shteteve të tjera.

Si dëshmi e kësaj, nënshkruesi duke qenë i autorizuar sipas të gjitha rregullave, ka firmosur këtë Konventë të hapur për firmosje sipas paragrafit 1 të nenit 12.

Miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike mbledhur në sesion të posaçëm në Vjenë, më 26.9.1986.